

PRISHTINA COMMON GROUND SUMMER FESTIVAL | P C G S F

16-17-18 korrik 2014

Komunikatë për media

PRISHTINA COMMON GROUND SUMMER FESTIVAL 2014 është një ngjarje tri ditore që do të zhvillohet më datë **16, 17** dhe **18 korrik** prej orës 10:00 deri në ora 23:00, ku disa nga hapësirat publike më interesante si dhe hapësirat dhe objektet e lëna pasdore në Prishtinë do të transformohen në hapësira të përbashkëta për art, relaksim, ushqim dhe këmbime ndërkombëtare. Aksionet e **artit publik**, sikur **Muzeu Aero Solar** në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës dhe **Ekskursionet** që nga Hamami i madh, Kulla e sahatit, deri te Muzeu etnografik dhe Qendra për Art Bashkëkohor Stacion, tregu i gjelbërt, xhamia e Çarshisë, xhamia e Jashar Pashës me historianë, arkitektë, aktivistë të kulturës dhe zyrtarë të qeverisë do t'ju bëjnë të zbuloni kufijt e qytetit të vjetër, trashëgiminë e arkitekturës moderne, peizazhin ujqor dhe mënyrën e të jetuarit në Prishtinë. **Ekspozitat** si Prishtina Common Ground me fotografitë e **Filippo Romanos dhe punëtoritë** si *New Born Spot* do të demonstrojnë mjetet e reja për interpretimin e tipologjive të hapësirave publike, instrumentet e artit për nisjen e hapësirave të përbashkëta dhe vendtakimeve që ndërlidhen me këmbimin e mallrave, kujdesin për shëndetin, lutjet. **Diskutimet publike** dhe **Ligjëratat publike** me arkitektët si **Gëzim Paçarizi**, kuratori i Pavijonit kosovar në Bienalen XIV të Venedikut, **Francesca Venier** arkitekte peizazhore nga Topotek1/Berlin, **Susanna Bortolotto**, profesoreshë e Konservimit dhe restaurimit në Departmentin e Arkitekturës dhe studimeve Urban, nga Politecnico di Milano, **Valeria Cifarelli** – dizajnere nga Controprogetto dhe **Public Tea** (diskutim gjatë së cilës pihet çaji tradicional) do t'ju lejojnë të testoni një vizion për qytetin, të diskutoni strategjitë për multikulturalizëm dhe të njihni aktorët lokalë dhe ekspertët europianë të cilët do të ofrojnë mjetet e tyre për rigjenerimin e hapësirave publike urbane (www.prishtinacgsf.org).

PRISHTINA COMMON GROUND SUMMER FESTIVAL me kuratorë **Isabella Inti**- profesore e Planifikimit Urban në Politecnico të Milanos, **Giulia Cantaluppi** – historiane e artit dhe aktiviste e "temporioso.net", Itali, **Rozafa Basha** - arkitekte dhe mësimdhënëse në departmentin e Arkitekturës, FNA, UP 'Hasan Prishtina', **Gyler Mydyti** - arkitekte, këshilltare për Urbanizëm dhe Planifikim, Komuna e Prishtinës, në bashkëpunim me grupin e studentëve ndërkombëtarë, Donald Alimi, Lazar Belic, Njomza Dragusha, Mikel Gonzales, Christoph Kirchberger, Krenare Juniku, Letizia Monti, Matteo Persichino, Joanna Zabielska, Erica Zorzi dhe video artistin italian Emanuele Mei.

Festivali përkrahet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të Republikës së Kosovës, DE.MO./MOVIN'UP I sess. 2014 nga Ministria Italiane e Kulturës dhe Turizmit, GAI - Associazione per il Circuito dei Giovani Artisti Italiani, OJQ-ja A.R.S. Progetti S.p.a., Komuna e Prishtinës, si dhe 4 Universitet, që janë DASTU, Departamenti i Arkitekturës dhe Studimeve Urbane, Politecnico di Milano, Universiteti Veror Ndërkombëtar i Prishtinës 2014, Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti i Arkitekturës, UBT - Universiteti për Biznes dhe Teknologji.

Media partnere ndërkombëtare dhe lokale KOSOVO 2.0 dhe magazina Abitare.